




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr Prot Br Prot Prot No
<u>DPKI</u>	<u>06-796/20</u>
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
<u>02</u>	<u>13.03.2020</u>



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2018 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin e Rregullores Nr.01/2014 dhe Rregullores Nr.01/2017 së punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë 10.03.2020, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-06/3014/19, për zyrtarin e lartë z. Sead Ujkani, Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Telekom i Kosovës Sh. A. për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokollit AKK-06-3014/19, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë Sead Ujkani, Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike Telekom i Kosovës Sh.A, është trajtuar sipas procedurave të parapara, për rastet e konfliktit të interesit apo papajtueshmërive në ushtrim të funksionit publik.

Pas verifikimit të informacionit dhe të dhënave tjera të siguruara nga Departamenti për OJQ, MAPL, është vërtetuar se zyrtari i lartë z. Sead Ujkani, Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen publike Telekom i Kosovës Sh.A, figuron si person i autorizuar dhe Drejtor në Organizatën Jo-Qeveritare "VESA" (Vizioni për Edukim Studim dhe Avancim), e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.06/L-011, neni 13 dhe 14, kjo situatë paraqet konflikt të interesit dhe papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik. Agjencia kundër Korrupsionit sipas procedurave të parapara e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit dhe se ai ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.



Pas kësaj shkrese z. Sead Ujkani, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar për një takim me zyrtarët e AKK-së, për tu njoftuar për situatën dhe rastin që ka të bëjë me të.

Zyrtarët e Agjencisë Kundër Korrupsionit, kanë shfrytëzuar kërkesën e zyrtarit z. Ujkani, dhe kanë organizuar një takim në zyrat e AKK-së. Në takimin e organizuar zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar atë me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar, duke e njoftuar se pas kontrollit dhe verifikimit është vërtetuar se ai figuron si person i autorizuar dhe Drejtor në Organizatën Jo-Qeveritare “VESA” (Vizioni për Edukim Studim dhe Avancim).

Në këtë takim zyrtari i lartë z. Sead Ujkani, pasi është informuar me faktet e prezantuara, ka deklaruar se Organizata Jo-Qeveritare “VESA” (Vizioni për Edukim Studim dhe Avancim), është e regjistruar por nuk ka zhvilluar aktivitete që një periudhë të gjatë, dhe nuk ka qenë i informuar se nuk ka të drejtë me ligjin e ri, të ketë pozitë udhëheqëse në një Organizatë Jo-Qeveritare, por ka theksuar se do të ndërmarr veprime sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit duke dhënë dorëheqje nga pozita si Drejtor në Organizatën Jo-Qeveritare “VESA” (Vizioni për Edukim Studim dhe Avancim).

Pas këtyre veprimeve nga zyrtari i lartë z. Sead Ujkani, kemi pranuar njoftimin për dorëheqjen e ofruar nga pozita e Drejtorit dhe përfaqësuesit të Autorizuar të Organizatës Jo-Qeveritare “VESA” (Vizioni për Edukim Studim dhe Avancim). Ndërkohë që pavarësisht këtij procesi, Qeveria e Kosovës me Vendimin e saj të datës 19.02.2020, ka shkarkuar Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore “Telekomi i Kosovës” Sh. A, ku edhe z. Sead Ujkani, ka qenë anëtar i këtij bordi.

Konstatohet se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Sead Ujkani, Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen publike Telekomi i Kosovës Sh.A, duke dhënë dorëheqje nga pozita si person i autorizuar dhe Drejtor në Organizatën Jo-Qeveritare “VESA” (Vizioni për Edukim Studim dhe Avancim), janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë.

Krijimi i rrethanave të reja, dorëheqja nga OJQ-ja dhe pastaj shkarkimi i bordit të Ndërmarrjes Publike Qendrore “Telekomi i Kosovës” nga Qeveria e Kosovës, janë dëshmi të mjaftueshme që tanimë nuk kemi me situatë të konfliktit të interesit, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit